



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.09.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i kalendarit 3-javor i punimeve të komisionit.
2. Miratimi i procesverbaleve të datave 3 dhe 20 korrik 2018.
3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit OPEC për zhvillim ndërkombëtar (OFID), për projektin e punimeve për riparime emergjente të autostradës Tiranë – Elbasan”.
4. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e dytë të financimit për projektin e sigurisë së digave”.
5. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main, për programin e rehabilitimit të konvikteve të Universitetit të Tiranës, sipas parimit të eficiencës së energjisë, faza II”.
6. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash, që përditëson marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Europiane (Europol), për bashkëpunimin strategjik dhe operacional, ratifikuar me ligjin nr. 28/2014”.
7. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së zbatimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Agjencisë

Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), për projektin “Këshillimi për migracionin në Shqipëri”.

8. Çështje të tjera.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Elona Gjebrea, Adnor Shamenti, Klotilda Bushka, Ervin Bushati, Eglantina Gjermani, Evis Kushi, Ilir Xhakolli, Andrea Marto dhe Vasilika Hysi.

Mungojnë:

Tritan Shehu, Klajda Gjoshaj, Edi Paloka, Rudina Hajdari, Edmond Panariti, Klevis Balliu dhe Nard Ndoka.

Të ftuar:

Damian Gjoknuri - Ministër për Infrastrukturën dhe Energjinë
Gledian Llatja - Drejtor i Kabinetit në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
Enea Karakaçi - Drejtor Juridik në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
Afrim Qendro - Drejtor i Përgjithshëm i Autoriteti Rrugor Shqiptar
Enkelon Topulli – Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
Gentian Keri - Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
Alfred Bundo - Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
Agim Bregasi - Drejtor i Energjetikës dhe Eficiencës së Energjisë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
Fatos Bundo - Drejtor i KESH-it
Arbian Mazniku - Nënkryetar i Bashkisë së Tiranës
Alban Dokushi - Drejtor i Përgjithshëm Juridik në Bashkinë e Tiranës
Erion Luçi - Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë
Dajna Sorensen – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë
Tedi Bushaj – Specialist në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
Brikena Jazxhi – Specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
Genta Prodani – Specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
Besfort Lamallari - Zëvendësministër i Brendshëm
Jeton Xoxa – Përfaqësues i Ministrisë së Brendshme

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëdita të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e parë të Komisionit për Politikën e Jashtme.

Ju uroj të gjithëve një sesion të mbarë parlamentar!

Kemi një rend dite relativisht të ngarkuar ku, pas miratimit të kalendarit 3-javor të komisionit dhe miratimit të procesverbaleve të datave 3 dhe 20 korrik, do të fillojmë menjëherë me shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit OPEC për zhvillim ndërkombëtar (OFID), për projektin e punimeve për riparime emergjente të autostradës Tiranë – Elbasan”.

Për të prezantuar shkurtimisht këtë projektligj të ftuar kemi ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë, zotin Gjiknuri.

Mirë se keni ardhur, zoti Ministër!

Të ftuar të tjerë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë kemi drejtorin e kabinetit, zotin Llatja, drejtorin Juridik, zotin Karakaçi, drejtorin e Përgjithshëm të ARRSH-së, zotin Qendro, dhe zotin Topulli, drejtor. Gjithashtu, prezent kemi edhe zëvendësministrin e Financave dhe Ekonomisë, zotin Luçi.

Pa humbur kohë do të fillojmë me miratimin e kalendarit 3-javor të punimeve të komisionit. Kush është dakord me kalendarin? Dakord!

Faleminderit.

Vazhdojmë me miratimin e procesverbaleve të datave 3 dhe 20 korrik. A ka kundërshtime? Nuk ka.

Miratohen.

Fillojmë me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit OPEC për zhvillim ndërkombëtar (OFID), për projektin e punimeve për riparime emergjente të autostradës Tiranë – Elbasan”.

Ministri Gjiknuri, fjala për ju.

Damian Gjiknuri – Faleminderit, zonja kryetare

Mirëdita, të nderuar anëtarë!

Në fakt, kjo kredi që po kalojmë, besoj se parlamenti do t’i japë dritën jeshile, shërben për investimet shtesë të një vepre, e cila ka mbetur pa u përfunduar. Bëhet fjalë për rrugën Tiranë-Elbasan, një rrugë me rëndësi shumë të madhe kombëtare, një rrugë që, fatkeqësisht, ka marrë shumë vite për t’u përfunduar, por pa miratimin dhe alokimin e këtyre fondeve kjo vepër nuk mund të përfundojë. Kjo është arsyeja pse qeveria i ka kërkuar Kuvendit që ta

miratojë dhe ta ratifikojë këtë marrëveshje me shpejtësi, në mënyrë që menjëherë të fillojë puna me intensitet të plotë.

Qëllimi final është që kjo rrugë të përfundojë brenda afatit të përcaktuar, që është brenda këtij viti. Në rastin më të keq punimet mund të zgjasin pak më shumë, por është shumë e rëndësishme që brenda këtij viti, në varësi edhe të kushteve atmosferike, kjo rrugë të jetë e hapur dhe e kalueshme. Pra, bëhet fjalë për segmentin nga fshati Ibë deri në tunelin e Elbasanit, për t'i dhënë fund përfundimisht të gjithë ngërçit të krijuar në këtë autostradë.

Nevoja për fondet shtesë ka qenë identifikuar edhe më parë. Po të shikoni segmentin e parë të kësaj rruge, i cili ka marrë më shumë fonde, fondi shtesë ka qenë i përcaktuar që në vitin 2016 me vlerë 150 milionë dollarë, por, fatkeqësisht, u siguruan vetëm 136 milionë. Pjesa e mbetur e fondit u bë i mundur pas negocimit shtesë me OPEC-un së bashku edhe me Ministrinë e Financave, i cili na mundësoi, nëpërmjet një kredie të butë, që këto fonde të lëvrohen përnjëherë, në mënyrë që ne të kemi mundësi ta përfundojmë veprën brenda afateve të përcaktuara.

Siç e thashë, vonesa e punimeve ka ardhur si rezultat i një sërë faktorësh, për shembull: keqmenaxhimi, probleme me projektin, vështirësi të mëdha gjeologjike dhe gjeoteknike, rrëshqitje të tokës, si dhe ka pasur punime shtesë në mënyrë të vazhdueshme, të cilat, faktikisht, kanë bërë që segmenti i rrugës Tiranë-Elbasan të dalë jashtë çdo lloj parashikimi dhe jo vetëm të kërkojë më shumë kohë, por edhe më shumë para nga buxheti i shtetit. Dua t'ju jap një shifër jo të mirë, por duhet të jemi transparentë me publikun. Kjo vepër ka qenë e planifikuar të mbarojë për 312 milionë dollarë dhe sot kostoja e rrugës ka shkuar 450 milionë dollarë.

Kuptohet që për këtë gjë është bërë një audit nga strukturat e specializuara të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Infrastrukturës, ka edhe një kallëzim penal, i cili po hetohet nga prokuroria, por unë nuk jam këtu për të evokuar këtë çështje. Ajo që dua them është se këto para do të përdoren kryesisht për përfundimin e kësaj vepre, përfshirë edhe zërat e nevojshëm për supervizimin, konsulencën, si dhe një fond i vogël rezervë në rast se ndodh ndonjë ngjarje e papritur, e jashtëzakonshme apo për punime që mund të dalin shtesë. Pra, bëhet fjalë për një fond jo më shumë se 1,5 milionë dollarë, që mund të përdoret për ekzekutimin e kontratës. Me pak fjalë, menjëherë sapo ta miratojmë këtë marrëveshje, ne jemi duke ushtruar trysninë e nevojshme te kontraktori, i cili ka lidhur kontratën me autoritetet shqiptare dhe me institucionin financiar, i cili ka dhënë kredinë, që është *consortiumi* i bankave islamike për të bërë të mundur përfundimin e kësaj vepre. Ne jemi

besimplotë se me vënin në dispozicion të parave vepra do të përfundojë ashtu siç duhet dhe në kohë të pranueshme.

Pak a shumë këto janë në vija të përgjithshme. Në qoftë se keni ndonjë pyetje, jam i hapur, por besoj se kjo marrëveshje nuk ka ndonjë gjë të veçantë financiare, është sikurse janë të gjitha marrëveshjet e tjera. Kuptimi i kësaj marrëveshjeje është se paratë shkojnë direkt për një nga veprat që realisht është kthyer në një gangrenë për infrastrukturën rrugore shqiptare për shumë vjet.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, Ministër!

Zoti Luçi, a keni ndonjë gjë për të shtuar lidhur me kushtet financiare të kontratës?

Erion Luçi – Shumë shkurt!

Shuma e kërkuar është 16 milionë dollarë me një interes relativisht të mirë me 2,75% normë vjetore për 20 vjet dhe 5 vjet *grace period*. Pra, kushtet janë po aq të mira siç kanë qenë edhe më parë. Ky fond vjen nga fondi “Objekte për zhvillim kombëtar”, i cili ka qenë pjesë financues i rrugës. Kështu, përveç pozitivitetit në dhënien e këtij fondi shtesë, ata kanë edhe njohurinë e nevojshme për të realizuar shumë shpejt projektin, sepse kanë qenë të përfshirë dhe e kanë supervizuar si projekt.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Luçi!

Në fakt, do të ishte patetike nga ana ime të thosha se sa të nevojshme janë rrugët për qytetarët shqiptarë. Ajo që dua të ndaj me ju është se, pas gjithë mungesave, sidomos të studimeve gjeologjike, ashtu sikurse ministri i përmendi, gjë të cilën ne e kemi thënë dhe rithënë edhe në kohën kur nuk ishim në qeverisje, kanë sjellë si pasojë këto diferenca të jashtëzakonshme të parave. Sot që flasim, pavarësisht se merret një kredi, janë taksapaguesit shqiptarë që do t’i rikthejnë këto para në xhepat e fondeve apo të bankave ndërkombëtare. Unë besoj se me këtë shumë që akordohet dhe me këtë marrëveshje ne do të mundësojmë riparimin dhe rritjen e sigurisë në këtë pjesë të autostradës Tiranë-Elbasan, sigurisht në vazhdimësi për ta përmbyllur këtë autostradë si një ndër nyjet kryesore vitale të infrastrukturës së vendit.

Adnor Shameti – Kam dy pyetje për zotin Gjikhuri.

Duke u nisur nga interesimi shumë i madh i publikut lidhur me përfundimin e kësaj rruge, pyetja ime e parë është: nga mediet jam njohur se bëhet fjalë për një kredi apo për një investim prej 35 milionë dollarësh, që janë dhënë vitin e shkuar. Çfarë fati patën këto 35 milionë dollarë?

Së dyti, a na siguroni ju se kjo do të jetë hera e fundit për ta përmbyllur 100% rrugën, duke përfshirë edhe atë pjesë të shkarjes së rrugës, që ndodhet pas tunelit të Elbasanit, si dhe sistemin e zonës, e cila është e mbyllur në njërën korsi në ardhje nga Elbasani për në Tiranë? Nëse do të m'i sqaronit këto gjëra në detaje do t'ju falënderoja shumë!

Mimi Kodheli - Zonjë Kushi, a kishit të njëjtën gjë?

Evis Kushi – Po, si dhe do të pyesja për pjesën e dytë, që lidhet me segmentin numër 3.

Mimi Kodheli – Po, zoti Ministër!

Damian Gjikhuri – Së pari, meqenëse janë dy pyetje që kanë lidhje me shembjen dhe segmentin numër 3, ajo pjesë e rrugës është marrë në dorëzim nga autoritet shqiptare dhe ka qenë përgjegjësi e autoriteteve shqiptare, që në këtë rast është Autoriteti Rrugor Shqiptar, për të bërë riparimin e kësaj vepre dhe nuk ka lidhje me këtë kredi. Unë mund t'ju them se Autoriteti Rrugor Shqiptar ka zhvilluar një procedurë tenderimi, pra ka alokuar fondet, dhe këto ditë është përzgjedhur edhe fituesi. Unë jam i bindur se brenda këtij muaji, pas lidhjes së kontratës, do të fillojë puna jo vetëm për heqjen e mbetjeve nga shembja, por për të gjithë sistemimin e një tuneli gjysmë të hapur dhe krijimin e në mbrojtjeje të nevojshme në të gjithë atë skarpat. Ajo zonë ka probleme të caktuara gjeologjike për shkak të ujërave që gjenden aty dhe shumë elementeve të tjerë gjeologjike, që unë nuk dua t'i futem. Njerëzit gjithmonë bëjnë pyetjen: pse nuk marrin disa ekskavatorë dhe t'i heqin mbetjet? Nuk është problemi të heqësh grumbullin e mbetjeve, por problemi është të sistemosh të gjithë skarpatin dhe inxhinierët gjeologë e dinë shumë mirë se duhen kampione gjeologjike, duhen bërë studime dhe duhet bërë një projekt i mirëfilltë, në mënyrë që të mos kemi përsëri rrëshqitje, sepse këto janë para të vazhdueshme që hidhen në rrugë.

Për sa i përket pyetjes së dytë, në lidhje me domosdoshmërinë dhe mjaftueshmërinë e këtyre fondeve shtesë që jepen, mund t'ju them se 35 milionët e parë që u dhanë patjetër që janë disbursuar dhe janë shpenzuar për sistemin të gjithë shembjes në fshatin Ibë dhe ajo është një gjë e dukshme që kushdo mund ta shikojë. Pra, është duke u përfunduar si kontratë. Këto fonde janë për pjesën e mbetur, që është asfaltimi, sistemi dhe mbrojtjet e nevojshme, ku ndodhi shembja në fshatin Ibë deri në tunelin e Kërrabës. Pra, kjo do të thotë se këto fonde janë të mjaftueshme për të realizuar këtë vepër, në mënyrë që të mos kemi më probleme. Mund ndodhin edhe gjëra të jashtëzakonshme si tërmeti apo gjëra të tjera, që njeriu nuk mund t'i parashikojë, por në këto kushte normale, me studimet e bëra, me dijenitë që kemi dhe me kushtet në të cilat ndodhet kantieri, kjo punë përfundon.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Ministër!

Besoj se është momenti që ne ta mbështesim ratifikimin e kësaj marrëveshjeje duke parë rëndësinë dhe emergjencën me të cilën ajo përballet, mendoj ta hedhim në votim projektligjin.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Kush është dakord me nenin 1, me ratifikimin e marrëveshjes? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2: Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit, zoti Ministër, për prezencën!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.09.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e dytë të financimit për projektin e sigurisë së digave”

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Elona Gjebrea, Adnor Shameti, Klotilda Bushka, Ervin Bushati, Eglantina Gjermeni, Evis Kushi, Ilir Xhakolli, Andrea Marto dhe Vasilika Hysi.

Mungojnë:

Tritan Shehu, Klajda Gjasha, Edi Paloka, Rudina Hajdari, Edmond Panariti, Klevis Balliu dhe Nard Ndoka

Të ftuar:

Gentian Keri - Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
Alfred Bundo - Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
Agim Bregasi - Drejtor i Energjetikës dhe Eficiencës së Energjisë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Fatos Bundo - Drejtor i KESH-it

Arbian Mazniku - Nënkryetar i Bashkisë së Tiranë

Alban Dokushi - Drejtor i Përgjithshëm Juridik në Bashkinë e Tiranës

Erion Luçi - Zvministër i Ekonomisë dhe Financave

Dajna Sorensen – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Tedi Bushaj – Specialist në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
Brikena Jazxhi – Specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
Besfort Lamallari - Zëvendësministër i Brendshëm
Genta Prodani – Specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
Jeton Xoxa – Përfaqësues i Ministrisë së Brendshme

Mimi Kodheli – Sipas rendit të ditës, vazhdojmë me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e dytë të financimit për projektin e sigurisë së digave”.

Mirë se keni ardhur miq të vjetër dhe të rinj, ekspertë digash!

Të ftuar për diskutimin e këtij projektligji kemi zotin Keri, sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, zotin Bundo, drejtor, zotin Bregasi, drejtor, si dhe zotin tjetër Bundo, drejtor.

Zoti Mazniku nuk është prezent?

(Diskutime pa mikrofon.)

Kemi prezent zotin Dokushi, drejtor juridik në bashkinë e Tiranës dhe zotërinjtë Bushaj dhe Jazxhi. Mirë se keni ardhur!

Zoti Keri, fjala për është për ju. Ju lutem, dy fjalë për ratifikimin e marrëveshjes për sigurinë e digave.

Gentian Keri – Faleminderit!

E nderuar zonja kryetare,

Të nderuar zotërinj anëtarë,

Qëllimi i projektligjit është ratifikimi i marrëveshjes për shtesën e dytë të financimit për projektin e sigurisë së digave, nëpërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim.

Objektivat e projektit janë: rritja e sigurisë së digave në hidrocentralet më të mëdha të sistemit elektroenergjitik në kaskadën e Drinit dhe rritja e sigurisë dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike nëpërmjet rritjes dhe përmirësimit të eficiencës së prodhimit të energjisë eklektike nga burimet hidrike.

Kjo është shtesa e dytë e financimit në masën 12 milionë euro dhe përbën fazën e pestë të këtij programi për sigurinë e digave. Ky financim konsiston në dy komponentë: në rehabilitimin e agregateve të turbinave nr. 4 dhe nr. 1 në hidrocentralin e Komanit dhe rehabilitimin e portave të shkarkimit dhe remontit në hidrocentralin e Fierzës dhe të Komanit, gjithashtu, përfshihet edhe ndjekja dhe supervizimi i këtyre aktiviteteve. Financimi shtesë prej 12 milionësh do të garantojë kompletimin e të gjitha furnizimeve, instalimeve, kryerjen e të gjitha provave, vënien në punë dhe dorëzimin e agregateve nr. 1 dhe nr. 4 në hidrocentralin e Komanit, financimin e konsulentit për implementimin e panelit të ekspertëve në projekt, në rolin e asistencës për menaxhimin e njësisë së projektit dhe suprevizionin e kontraktorit.

Zbatimi i projektit do të bëhet nga KESH-i, deri më 31 dhjetor 2020. Fondet e kredisë do të nënhuazohen cash me të njëjtët terma të marrëveshjes së huasë, nëpërmjet një

marrëveshje nënhuaje e bërë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe subjektit zbatues të sipërpërmendur.

Huaja do të akordohet nëpërmjet një marrëveshjeje dhe ka termat financiarë të mëposhtëm: shuma është 12 milionë euro, interesi është i bazuar në normën e referencës plus një marsh të pandryshueshëm, tarifa afron te 0,25% te shumës së huas, komisioni i angazhimit është 0,25, që llogaritet mbi vlerën e padisborsuar të vlerës së huas.

Mimi Kodheli – Zoti Keri, për termat e huas do të flasë zëvendësministri. Mbasi zoti Luçi të na flasë dy fjalë për termat e huas, unë dua të di nga ju se sa të sigurta janë digat sot dhe a mjaftojnë 12 milionë euro të bëhen edhe më të sigurta?

Fjalën e ka zoti Luçi.

Erion Luçi – Dua të theksoj se kjo është një fazë e avancuar e këtij projekti dhe më në fund jemi në finalizimin e projektit, prandaj edhe termat kredisë janë të ngjashëm me termat e mëparshëm, me një normë bazë që është rreth 2% plus disa shtesa, me rreth 0,25%, të pandryshueshme gjatë vitit dhe maturimi është brenda 23 vjetëve, me 7 vjetët e para pa pagesë principale, prandaj normat janë relativisht shumë të mira nga kreditë e Bankës Botërore.

Dua të theksoj faktin që është ndër projektet më të gjata dhe relativisht më komplekse, këtë mund ta thonë edhe ekspertët. Kjo shtesë vjen si zgjerim i disa elementeve, që gjatë analizës pak më të thellë për sigurinë e tyre, ishte e nevojshme që portat e shkarkimit të futen brenda remontit të madh që po u bëhet digave.

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Kuptoj që termat e referencës janë pak a shumë të njëjta me termat në fillim të marrjes së huasë, që duke ditur që tregu ndryshon, kjo tregon se është bërë një punë e mirë në këtë drejtim. Përveç pyetjes që mund të duket bombastike, se sa mund të jenë të sigurta digat, dua të di se sa është i përfshirë pushteti lokal në mirëmbajtjen dhe sigurinë e digave, sepse dikur ia hoqëm përgjegjësinë për të menaxhuar digat, por sot shikoj se kjo përgjegjësi është rikthyer? A do të ketë pushteti lokal ndonjë zë për këtë gjë (megjithëse duhet të ishin prezent, por nuk janë), apo do të vazhdojmë t'i menaxhojmë ashtu siç ka qenë tradita kur këto diga u ndërtuan, sepse nuk e di nëse ndërtohen të reja sot, por besoj se menaxhojmë ato që kemi trashëguar apo jo?

Agim Bregasi – Po. Dua të bëj thjesht një dallim ndërmjet digave të mëdha të hidrocentraleve dhe digave të kanaleve ujitëse, që janë ujëmbledhësa, të cilat janë shumë të shpërndara dhe sa herë që ka përmbytje përbëjnë rrezik. Ka një program për rehabilitimin e tyre, por patjetër që duhet bërë në koordinim me pushtetin lokal dhe me agjencitë e kullimit

dhe ujitjes, të cilat në disa zona të Shqipërisë janë eficiente, por ka zona të tjera që mbeten mbrapa, për sa i përket marrjes së tarifave dhe rehabilitimit të digave. Pra, po flasim për dy menaxhime të ndryshme, për menaxhimin e hidrocentraleve dhe kaskadave të cilat janë të centralizuara dhe për këto diga që janë të decentralizuara nga agjencitë e ujitjes dhe kullimit.

Mimi Kodheli – Mendoj të vazhdojmë me pyetjet, sepse është një temë e rëndësishme. Kur fola për digat pata parasysh ato dhe këto diga. Ju zoti Luçi, jeni shumë i ri krahasuar me mua dhe aq më tepër zoti Keri, por dikur digat ishin objekt i rëndësisë së veçantë, ruheshin në mënyrë të veçantë dhe kishte një protokoll të veçantë që lidhej me sigurinë e tyre, sepse si një digë ujëmbledhësi apo një digë hidrocentraleli dëmtojnë që shkaktojnë janë kolosale dhe të jashtëzakonshme. Kjo shtesë që i bëhet kësaj marrëveshje huaje përfshin edhe digat që menaxhon pushteti lokal apo po flasim ekskluzivisht vetëm për digat e mëdha.

Agim Bregasi – Pyetja është me shumë interes, sepse ne kemi 640 diga, duke përfshirë edhe digat që menaxhoheshin nga bujqësia dhe që shërbejnë për ujitje. Ky financim shkon vetëm për digat që administrohen nga KESH-i, pra* që është shoqëri me kapital 100% shtetëror.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është tjetër, është për qytetin student.

Pra 12 milionë euro shkojnë për KESH-in për rehabilitimin e portave të shkarkimit për të rritur sigurinë e shkarkimit dhe për ndërhyrje në turbina.

Pyetja tjetër, është e vërtetë që para tri vjetësh digat që administroheshin nga bujqësia kanë kaluar te pushteti vendor, por nga pikëpamja e kapaciteteve teknike pushteti vendor ka vështirësi në menaxhimin e tyre, sepse domosdoshmërisht duhen kuadro hidroteknike, që janë specialistë për digat, por edhe fondet e kanë vështirë për t'i siguruar. Mendoj se informacionin më të plotë mund ta merrni nga Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha, që është një strukturë në varësi të Këshillit të Ministrave dhe ka një evidencë të plotë.

Ka rreth një vit që ka filluar një punë sistematike për evidentimin e situatës së digave, që janë në varësi të pushtetit vendor, për të parë gjendjen dhe problematikat e tyre, sepse shpeshherë poshtë digave janë ndërtuar banesa me leje apo pa leje, pra është edhe një problem jo vetëm social, por me pasoja të rënda për jetën e njerëzve. Nga Komiteti Kombëtar i Digave ka filluar një aksion i vërtetë, jo në kuptimin kalimtar të aksionit, por po bëhet një punë sistematike për evidentimin e problematikave në digat që kemi, cilat janë të mbushura dhe cilat duhen nxjerrë nga inventarët dhe nuk duhen shfrytëzuar më, gjithashtu për marrjen e masave për pastrimin e llumrave që mund të kenë, sepse po u çahet diga mund të shkaktojnë probleme në zonën poshtë. Ka edhe diga të tjera të ndërtuara nga shoqëri private, siç është

hidrocentrali i Banjës, apo dhe të tjerë që menaxhohen nga privatët, por që janë në mbikëqyrje të rreptë nga Komiteti Kombëtar i Digave, si në projektin e tyre, si në zonën e përmytjes, në masat që merren për të paralajmëruar në përmytjet e mundshme e të tjera.

Pra po të shikojmë 640 digat kanë një ndarje teknike, deri në 15 metra quhen diga të vogla dhe ishin nën administrimin e bujqësisë, ndërsa të tjerat quhen diga të larta dhe janë nën administrimin nga KESH-i dhe privatët.

Në vijim të fjalës së zotit Luçi, mund të them që nga ish-digat që kishte bujqësia 14 prej tyre kanë përfituar nga një kredi e Bankës Botërore dhe janë rehabilituar gjatë këtyre 2 vjetëve të fundit. Mendojmë se investimet do të vazhdojnë, por nga Komiteti Kombëtar i Digave në bashkëpunim me pushtetin vendor do të bëhet klasifikimi i digave, nëse vlejnë apo jo, nëse ka më toka për të ujitur apo jo, nëse ka probleme me banorët apo jo dhe nëse janë të mbushura me aluvione. Pra kjo është situata në përgjithësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Realisht është mbledhur informacion nga të gjitha bashkitë dhe Komiteti Kombëtar i Digave po bën klasifikimin e informacionit që ka ardhur nga bashkitë, për të ndarë se çfarë do të bëhet me secilën nga digat dhe çfarë financimi duhet bërë dhe pastaj të bëhet dhe sigurimi i këtyre financimeve hap pas hapi.

Për sa u përket digave që administrohen nga KESH-i, them që kemi një program shumë të qartë për rehabilitimin e tyre, e cila quhet “Siguria e digave”, por në vetvete përfshin edhe rehabilitimin e turbinave, siç është edhe ky financim nga ku do të rehabilitohen diga nr. 1 dhe nr. 4 e hidrocentralit të Komanit, tek të cilat nuk është vënë dorë që kur është ndërtuar. Pra në kuptimin e përgjithshëm duket sikur ka të bëjë vetëm me digën, por ka të bëjë me gjithçka edhe me turbinën, edhe me portat, edhe me vetë digën.

Për informacion mund të them se ka përfunduar rehabilitimi i digës së Komanit, sidomos i bjefit të poshtëm që ishte bërë problem, sepse kishte gërryerje nga shkarkimet e viteve 2010 – 2011, por edhe në 20 vitet më përpara. Pra është arritur të rehabilitohet pjesa e bjefit të poshtëm e këmbës së digës nga ana e hidrocentralit, duke realizuar mbrojtjen e digës. Kjo është një tablo e përgjithshme.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Bregasi!

Përpara se të marr një përgjigje nga zoti Bundo, në lidhje me pyetjen që bëra lidhur me sigurinë e digave, do t’ia jap fjalën zotit Bushati.

Përfitoj nga rasti, duke qenë se jam deputete dhe duke pasur mikrofonin përpara që të konsiderohet një rikonstruktiv i mirë i njëres prej digave problematike, me të cilën jam përballur gjatë punës sime të mëparshme në Kavajë, dhe gjithashtu, kthimin në gjendje pune

të digës në Golaj të Hasit, e cila është hedhur në erë në vitin 1997 dhe që nga ai moment nuk ka funksionuar më dhe e gjithë zona vuan mungesën e vaditjes dhe ujitjes së terreneve.

Fjalën e ka zoti Bushati.

Ervin Bushati – Faleminderit!

Dua të di nëse ka ndonjë studim të vlerës reale, me vlerën e tregut sot, se çfarë pasurie kemi, meqenëse digat janë një nga pasuritë më të mëdha dhe po shfrytëzojmë akoma ato investime që janë kryer në pjesën më të madhe nga sistemi i kaluar? Pra a ka ndonjë studim për vlerën realeve të digave që ne kemi sot të trashëguara, sepse edhe kostot e mirëmbajtjes janë në proporcion të drejtë?

E dyta, në të gjitha këto studime që keni bërë a janë futur edhe digat me investime private, kur ndodh diçka, nuk do të diskutohet më nga qytetarët nëse ishte e KESH-it, ishte e shtetit apo ishte private.

Së treti, të gjithë e kemi të qartë se niveli i rrezikut po rritet për arsye të rritjes ekonomike, të investimeve dhe të ngrohjes globale.

Gjithashtu, jemi të gjithë dëshmitarë të rasteve më të shpeshta të zjarreve në kohën e verës ose të përmytjeve në kohën e dimrit. A keni një plan strategjik për këtë duke pasur parasysh se ne do të duhet të fillojmë të mendojmë dhe për pas 10 vjetësh?

Mimi Kodheli - Faleminderit!

Zoti Bregasi.

Agim Bregasi - Siç e përmenda dhe pak më parë tani po bëhet vlerësimi i të gjitha digave. Komiteti Kombëtar i Digave ka marrë informacion nga të gjitha bashkitë për digat jo thjesht si inventar, por për gjendjen e tyre, në çfarë shtate janë dhe sa do të duhet për t'i rehabilituar.

Të thuash sa kushton një digë, sot është e vështirë, sepse objektet vlerësohen në tërësinë e tyre, siç mund të themi për hidrocentralet e Devollit, investimi i të cilëve shkon 800-900 milionë euro, por aty nuk është vetëm diga, por janë të gjitha llojet e punimeve, si ato mbështetëse, ndërtesa e centralit, turbina dhe gjeneratorët. Pra, flitet në total sa kushton kjo vepër. Por besoj se me atë punë që po bëhet edhe nga Komiteti i Digave që tashmë kanë mbledhur informacion dhe me siguri pas disa muajsh do të kemi një evidencë të plotë sa diga kemi, në çfarë gjendje i kemi dhe sa është vlera në tregun e sotëm që të japim një përgjigje më të saktë.

Ervin Bushati – Para disa vitesh u privatizuan tre hidrocentrale, me një vlerë që mund të na nxjerrë në ndonjë diskutim subjektiv, sepse ne që ishim në opozitë thoshim është pak, maxhoranca thoshte është shumë, sot nuk diskutohet më fare. Nëse ne bëjmë një

inventarizim, për shembull, për hidrocentralin e Devollit e kuptojmë, është më e kollajta për t'u mbledhur, se janë norvegjez dhe i kanë të gjitha të dhënat, por unë po pyes për hidrocentralin e Fierzës, sa vlen sot, jo atëherë, që të dimë edhe ne se çfarë kemi asete kombëtare dhe si duhet të menaxhohen. Kjo është minimalja dhe kjo punë duhet të nisë tani. Me një takim një orësh me ata të Devollit ne e gjejmë, na i japin të dhënat e sakta. Tani duhet të bëjmë një punë serioze që nesër të mos kemi më nga këto diskutimet jo shiko se më shumë na kushton se sa na vlen diga dhe pastaj papritmas privatizohet në një vlerë që populli shqiptar do ta vuajë. Nga administrata duhet bërë një punë që të vlejë për Shqipërinë.

Alfred Bundo - Në lidhje me pyetjen tuaj, zonja kryetare e komisionit, unë mund të deklaroj se investimet e kohëve të fundit qoftë nga Banka Botërore, qoftë nga vetë Korporata Elektroenergjetike Shqiptare për sigurinë në diga janë shumë domethënëse. Unë mund t'ju siguroj se digat janë të sigurta. Siç e tha dhe zoti Bregasi, kohët e fundit ne nëpërmjet BERZH-it realizuam një financim prej 7 milionë eurosh, duke bërë rehabilitimin total të digës së Komanit. Nuk kemi asnjë problem në digën e Fierzës dhe nuk kemi asnjë problem me digën e Vaut të Dejës. Financimi shtesë, që ne po kërkojmë sot, është si aset shtesë për marrjen e masave pasi portat e shkarkimit, siç e tha dhe zoti Bregasi, kanë vite të tëra që janë montuar dhe nuk është realizuar asnjëherë rehabilitimi i tyre në total. Do të thotë që ne po marrim masa suplementare në lidhje me sigurinë digave, por kjo nuk do të thotë se digat janë në gjendje të keqe ose kanë rrjedhjet e tyre, megjithëse kanë 40 vjet që janë montuar portat e shkarkimit.

Në lidhje me pyetjen që bëri zoti Bushati, në kuadër të ndryshimeve klimatike, ne kohët e fundit kemi vërejtur se sasia e prurjeve është shumë herë më e madhe se në të kaluarën. Detyrimisht ne do të kemi një mirëmenaxhim më të mirë. Për të rritur këtë menaxhim të pllotave që vijnë nga reshjet, nga bora ne duhet të kemi në operativitet të plotë portat, sepse ju e dini që porta nr.3 e hidrocentralit të Fierzës nuk është hapur asnjëherë, sepse që në momentin e ndërtimit ka pasur probleme. Atëherë me këto investime që ne do të realizojmë tani, do të kemi operativitet të plotë të 4 portave të shkarkimit që do të thotë një mirëmenaxhim i të gjitha pllotave që mund të ndodhin në të ardhmen.

Mimi Kodheli – Faleminderit, për përgjigjen tuaj!

Kjo na bën ende më besimplotë edhe dëshirëplotë që ne ta kalojmë këtë projektligj.

Kalojmë në votimin në parim. Kush është dakord me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit zotërinj, për prezencën!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.09.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit OPEC për zhvillim ndërkombëtar (OFID), për projektin e punimeve për riparime emergjente të autostradës Tiranë – Elbasan”.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Elona Gjebrea, Adnor Shamenti, Klotilda Bushka, Ervin Bushati, Eglantina Gjermeni, Evis Kushi, Ilir Xhakolli, Andrea Marto dhe Vasilika Hysi.

Mungojnë:

Tritan Shehu, Klajda Gjasha, Edi Paloka, Rudina Hajdari, Edmond Panariti, Klevis Balliu dhe Nard Ndoka.

Të ftuar:

Erion Luçi - Zëvendësministër i Ekonomisë dhe Financave

Arbian Mazniku - Nënkryetar i Bashkisë së Tiranës

Tedi Bushaj – Specialist në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Brikena Jazxhi – Specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Gentian Keri - Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Mimi Kodheli - Kalojmë në diskutimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe KfW Frankfurt am Main, për programin e rehabilitimit të konvikteve të Universitetit të Tiranës sipas parimit të eficiencës së energjisë faza II”. Të pranishëm kemi përfaqësuesit e Bashkisë së Tiranës, zotin Mazniku nënkryetar i saj, zotin Bushaj, dhe zotin Jasxhi, zoti Luçi.

Erion Luçi – Faleminderit!

Ky është një grant, për të cilën mund të shmangej ardhja në parlament, sepse nuk krijon detyrime financiare për taksapaguesit. Është një gjë shumë pozitive në aspektin e energjisë së rinovueshme dhe ka filluar të ketë kërkesa jo të vogla edhe për ta financuar ose për t’i zgjeruar këto financime edhe me borxh. Domethënë është një projekt relativisht i mirë që mund të shpjegohet nga ministria përkatëse. Pra, nuk futet te kategoria e dy transheve të mëdha të këtij granti, që u kaluan thjesht me vendim të Këshillit të Ministrave. Ne po mundohemi të lehtësojmë punën e parlamentit për këtë lloj instrumenti që është pa implikime financiare. Është një ofertë mjaft gjeneroze që po bën BE-ja me KfW, të cilët kombinojnë këto grante.

Mimi Kodheli – Unë jam shumë mirënjohëse, zoti Luçi, që ju po kujdesieni për kohën tonë të çmuar dhe jam plotësisht dakord me ju që marrëveshje të tilla nuk kanë pse kalojnë në parlament, kur nuk ka efekte financiare dhe kur Shqipëria dhe qytetarët e saj janë përfitues pa qenë e nevojshme të kthejnë diçka mbrapsht. Por kjo është një arsye më e mirë, të paktën edhe në këtë rast që ne të dimë çfarë ndodh, cila është situata e konvikteve në Universitetin e Tiranës, sa eficientë jemi në shfrytëzimin e asaj që ne mund të përfitojmë nga gjeneroziteti i të tjerëve dhe taksapaguesve që nuk janë ata shqiptarë dhe cila është perspektiva. Besoj se është një rast i mirë që ne të mund të ndajmë bashkërisht problematikën dhe pse jo edhe zgjidhjen nëse ka.

Mimi Kodheli - Faleminderit!

Gentjan Keri - Atëherë kjo marrëveshje synon financimin me një grant shtesë prej 2 milionë e 32 mijë eurosh për programin e rehabilitimit të konvikteve të Universitetit të Tiranës, sipas parimit të eficiencës së energjisë. Në vitin 2016 me ligjin nr. 69 është ratifikuar tashmë në vlerën 4,5 milionë euro faza e parë. Kjo është faza e dytë prej 2 milionë eurosh dhe 32 mijë që i shtohen gjithë programit për rehabilitimin e Qytetit Studenti nr. 1. Financimi i bashkohet qëllimit për aplikimin e masave të eficiencës së energjisë dhe ka të bëjë me shumë me auditimin energjik të ndërtesave për identifikimin e konsumit të energjisë,

identifikimin e nevojave për rinovimin e ndërtesave në lidhje me gjendjen aktuale, me qëllim zgjatjen e ciklit të ndërtesave, reduktimin e konsumit të përgjithshëm të energjisë duke synuar që treguesi i performancës së energjisë elektrike të jetë 75 kilovat për metër katrorë në ditë dhe reduktimin e të dyoksidit të karbonit, si rezultat i masave dhe vendosjes së kushteve të performancës së lartë sipas standardeve të Bashkimit Europian. Nga programi do të përfitojnë 1000 studentë dhe projekti parashikohet të fillojë në vitin 2018 dhe të zgjasë 24 muaj. Vlera e projektit është 6,5 milionë euro dhe përfituesit do të jetë rezidenca studentore universitare nr.1.

Ky projekt do të përfshijë rehabilitimin e 5 konvikteve sipas përcaktimit në marrëveshjen financiare të dakordësuar nga KfW-ja me qeverinë shqiptare. Kemi edhe një premtim nga KfW-ja për një grant të tretë në vlerën maksimale 2,9 milionë euro, i cili do të bëjë të mundur rehabilitimin edhe të dy godinave të tjera.

Arbian Mazniku- Në mënyrë kronologjike historia e këtij granti fillon nga vizita e zonjës Merkel në Tiranë, e cila gjatë vizitës angazhoi qeverinë gjermane për grantin e parë prej 4,5 milionë eurosh, i cili filloi funksionimin gjatë procesit të auditimit dhe vlerësimit të objekteve. U vlerësua nga pala gjermane, e cila po e bën këtë vlerësim, pra kanë ardhur specialistët e KfW-së dhe po bëjnë vlerësimin, sipas të cilit duhen pak më shumë para për të arritur ato objektiva që ata kishin. Prandaj është rënë dakord nga pala gjermane për ta kaluar grantin në total nga 4,5 në 6,5 milionë euro duke shtuar 2 milionë euro të tjera grant. Në thelb e gjithë marrëveshja miraton dakordësinë tonë si shtet shqiptar për të pranuar këtë grant.

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Unë besoj se nuk ka vend për komente të tjera.

Më vjen mirë që atraktojmë qeveri si ajo gjermane, sidomos kur flitet për Tiranën dhe studentët.

Kalojmë në votimin në parim.

Kush është dakord me ratifikimin e marrëveshjes? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Miratohet.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.09.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash që përditëson marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Europiane (Europol), për bashkëpunimin strategjik dhe operacional, ratifikuar me ligjin nr. 28/2014”.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Elona Gjebrea, Adnor Shameti, Klotilda Bushka, Ervin Bushati, Eglantina Gjermani, Evis Kushi, Ilir Xhakolli, Andrea Marto dhe Vasilika Hysi.

Mungojnë:

Tritan Shehu, Klajda Gjasha, Edi Paloka, Rudina Hajdari, Edmond Panariti, Klevis Balliu dhe Nard Ndoka.

Të ftuar:

Jeton Xoxa – Përfaqësues i Ministrisë së Brendshme

Mimi Kodheli - Vazhdojmë me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese në shkëmbim notash që përditëson marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe zyrës së Policisë Europiane (Europol) për bashkëpunimin strategjik dhe operacional të ratifikuar me ligjin nr. 24/2014”.

Ku është zëvendësministri, zoti Besfor?

Atëherë keni fjalën, zoti Xoxa.

Jeton Xoxa- Sot prezantohet projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash, që përditëson marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Europiane (Europol), për bashkëpunimin strategjik dhe operacional, ratifikuar me ligjin nr. 28/2014”.

Në datën 1 maj 2017 ka hyrë në fuqi rregullorja e re e Europol-it dhe si rrjedhojë ka ndryshuar edhe kuadri ligjor i saj. Mandati i ri Europol mbulon vepra penale, të cilat kanë të bëjnë me krimet e rënda, terrorizmin dhe forma të tjera të krimit, të cilat prekin dy ose më shumë vende të BE-së. Projekti do të kontribuojë për të rritur bashkëpunimin në luftën kundër formave të rënda të krimit ndërkombëtar si edhe në kuadër të angazhimeve të ndërmarra nga Shqipëria për përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në Marrëveshjen e Stabilizim - Asocimit, gjithashtu edhe në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit.

Mimi Kodheli - Zoti Xoxa, ju kërkoj ndjesë për ndërprerjen!

Ky është një projektligj për të cilin ka ekzistuar një marrëveshje e mëparshme, dhe kjo besoj e ratifikon marrëveshjen me ndryshimet përkatëse.

Do t’ju lutesha, të na shpjegonit se cili është ndryshimi midis marrëveshjes së parë dhe të dytë që e bën të domosdoshme këtë gjë? Cila është gjëja thelbësore?

Jeton Xoxa – Te marrëveshja e parë është një aneks, në të cilin janë radhitur të gjitha veprat penale për të cilat bashkëpunohet me Europolin.

Te marrëveshja ndryshuese, ndryshon aneksi dhe shtohen disa vepra penale tek aneksi i marrëveshjes ekzistuese që është ratifikuar, që janë: terrorizmi, krimi i organizuar, krimi kundër interesave financiarë të BE-së, manipulimi i brendshëm dhe manipulimi i tregut financiar, vepra të tilla që i shtohen listës së veprave që bashkëpunojnë me Europolin.

Mimi Kodheli - Kolegia Gjebrea, ka një pyetje për ju.

Elona Gjebrea – Ju falënderoj drejtor!

Kjo është një marrëveshje e rëndësishme për sa i përket bashkëpunimit midis policisë shqiptare dhe Europolit dhe do të doja të dija nëse kemi një rritje të shkëmbimeve në vite ndërmjet zyrës sonë dhe Europolit.

Sa eficiente është zyra e policisë atje, se, me sa di, kemi edhe një oficer policie të dërguar nga ne?

Faleminderit!

Jeton Xoxa – Shkëmbimi i informacioneve me Zyrën e Europolit ka ardhur gjithnjë në rritje. Tashmë prej disa vitesh kemi një oficer ndërlidhës në Hagë, i cili ndihmon në shkëmbimin e informacioneve që kanë pasur gjithnjë e më shumë intensitet.

Ndërkohë, së shpejti në Kuvend do të vijë për shqyrtim projektligji i ri “Për instalimin e oficerit ndërlidhës të Europolit në Shqipëri”, që do të jetë e dyanshme. Kjo tregon edhe interesin e Europolit për një bashkëpunim më intensiv me Republikën e Shqipërisë.

Mimi Kodheli - Mendoj se ratifikimi i kësaj marrëveshjeje, siç e thatë edhe ju, sjell një intensifikim të strukturave tona policore dhe të sigurisë me Europolin, bashkëpunim, i cili tashmë është strategjik dhe operacional, kështu që nuk mbetet gjë tjetër veçse të kërkoj hedhjen në votë të ratifikimit të kësaj marrëveshjeje me ndryshimet përkatëse, sipas aneksit që përmendi zoti Xoxa, dhe të procedojmë më tutje.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Neni 1, “Ratifikimi i marrëveshjes”? Kundër, abstenim, nuk ka!

Ju faleminderit!

E hedhim në votë në tërësi projektligjin?

Ju faleminderit!

Faleminderit, zoti Xoxa, për prezantimin!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.09.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së zbatimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), për projektin “Këshillimi për migracionin në Shqipëri”.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Elona Gjebrea, Adnor Shameti, Klotilda Bushka, Ervin Bushati, Eglantina Gjermani, Evis Kushi, Ilir Xhakolli, Andrea Marto dhe Vasilika Hysi.

Mungojnë:

Tritan Shehu, Klajda Gjoshaj, Edi Paloka, Rudina Hajdari, Edmond Panariti, Klevis Balliu dhe Nard Ndoka.

Të ftuar:

Dajna Sorensen – Zëvendësministre e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë
Genta Prodani – Shefe sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Mimi Kodheli - Së fundi, për diskutim është projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së zbatimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), për projektin “Këshillimi për migracionin në Shqipëri”.

Zonja Sorensen, fjala për ju.

Faleminderit!

Dajna Sorensen – Përshëndetje të gjithëve!

Shkurtimisht do t’ju flas për projektligjin në fjalë. Ky projektligj parashikon të ratifikojë marrëveshjen e zbatimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), në kuadër të zbatimit të projektit “Këshillimi për migracionin në Shqipëri”.

Projekti është pjesë e një programi global të GIZ-it, që është autorizuar nga BMZ-ja, që është Ministria Federale Gjermane për bashkëpunimin ekonomik dhe zhvillimin.

Objekti i këtij projekti në vetvete është parandalimi i migracionit të parregullt duke i informuar të gjithë ata që janë target potencial për migracion jo të rregullt, mbi mundësitë e tregut të punës në Shqipëri.

Projekti në vetvete është i ankoruar pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit, pra, pranë sporteleve të zyrave të migracionit dhe synon të krijojë një sërë elemente informuese mbi mundësitë e tregut të punës në Shqipëri dhe mundësitë për arsim dhe formim profesional në Shqipëri.

Një tjetër element i këtij projekti është gjithashtu edhe informimi i atyre personave për migracionin e rregullt në Gjermani. Këto janë dy elementet dhe këndvështrimet kryesore të këtij projekti.

Sikurse në rastin e mëparshëm, sërish bëhet fjalë për një marrëveshje granti, vlera e së cilit në total shkon 1,5 milionë euro, 90 mijë euro janë kostot lokale në formën e TVSH-së, që janë të parashikuara për periudhën e viteve 2018-2020.

Jam e hapur për pyetjet që mund të keni.

Mimi Kodheli – Kostot e TVSH-së flitet që do të paguhen nga buxheti i shtetit, apo jo?

Para se zonja Gjebrea të vazhdojë me pyetjen, pikë së pari, prezent këtu nuk duhet të ishin vetëm përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, por edhe nga Ministria e Shëndetësisë dhe Punëve Sociale. Si dhe cilët i menaxhojnë zyrat e punës?

Dajna Sorensen – Ministria e Financave, Shërbimi Kombëtar i Punësimit...

Mimi Kodheli - Kërkoj ndjesë atëherë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju sot menaxhoni edhe këtë pjesë!

Organizimi i ri na i ka ngatërruar idetë!

Përtej rëndësisë që ka këshillimi për migracionin, t'ju them të drejtën, jam skeptike lidhur me rezultatet!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shpresoj shumë të mos ketë bazë skepticizmi im dhe të jetë thjesht një perceptim. Ka një matës se cilat kanë qenë rezultatet e këshillimit nga momenti që ka filluar projekti e deri më sot dhe për pasojë lindi si nevojë vazhdimi i këshillimit, apo për shkak të mos pasjes së rezultateve, preferojmë të ratifikojmë këtë marrëveshje duke shpresuar që një ditë do të ketë bazë të mirë reale puna me qytetarët për pamundësinë apo mundësinë e migrimit dhe gjetjes së vendit të punës? Më duket ende shumë kaotik, ende shumë i pabazuar në informacion! Ndoshta ky perceptim është i gabuar, por nëse do të më thoshit se ka një koeficient matës dhe një shifër, unë e tërheq perceptimin tim skeptik lidhur me pyetjen time.

Duhet të më përgjigjeni pasi zonja Gjebrea të procedojë me pyetjen e saj.

Elona Gjebrea –Faleminderit, kryetare!

Faleminderit, zonjat zëvendësministre, për sqarimin!

Në fakt, me thënë të vërtetën, nuk më tingëllon mirë si titull “Këshillimi për migracionin”, ndërkohë, po të lexohet me vëmendje bëhet fjalë për luftën kundër migracionit të parregullt, etj.

Në informacionin që kam, menaxhimi i emigrantëve që kthehen nga jashtë është bërë në koordinim midis Ministrisë së Dikurshme të Punëve dhe Çështjeve Sociale dhe Ministrisë së Brendshme, sepse ka një ndërthurje. Në shumë vende dhe zyra ofrohen në sportelet e Policisë Kufitare, në Rinas të paktën, përveç asaj që, informacionin për kthimin e migrantëve e ka Policia Kufitare nëpërmjet sistemit TIMS etj., gjithsesi kjo nuk ka rëndësi. Është për t'u përshëndetur si iniciativë, por mendoj se në radhë të parë, duhet të punohet me pushtetin lokal, pasi shumë nga migrantët kthehen në mënyrë vullnetare, edhe për t'i shpëtuar penalizmit nga lëvizja në vendet Shengen, kështu që bëhet i vështirë identifikimi i tyre. Pushteti lokal luan një rol kryesor për të identifikuar këtë grup dhe për të bashkëpunuar. Në radhë të parë, për mua, është fuqizimi ekonomik, pra arsyet përse ata ikin dhe fuqizimi ekonomik në vendin e tyre.

Thashë edhe më parë, termi “Këshillim” është pjesë e punës, por besoj se ka edhe një strategji për migrantët e kthyer. Ministria e Punës dikur e ka pasur në program, në mënyrë të

rregullt këtë strategji dhe që patjetër është një udhërrëfyes për politikat e mira, që sigurisht, një ndër këto është edhe këshillimi dhe ndërgjegjësimi, që duhen patjetër.

Nga ana tjetër, ky është një sugjerim imi, që duhet që në mënyrë të vazhdueshme të bëni edhe sensibilizim në medie me buxhetet që keni, për sa u përket gjithë penalizimeve, që kanë migrantët që shkojnë apo kthehen në vendet përkatëse.

Ju faleminderit!

Dajna Sorensen – Ndoshta do të ishte me vend të kisha listuar listën e elementeve që parashikohet në kuadër të këtij projekti. Një sërë elementesh të parashikuara këtu janë paketa informuese, të cilat do të përcillen nga mënyrat më të ndryshme, siç është media vizive apo sociale, për të informuar pikërisht këtë target grup. Këtu bëhet fjalë për dizenjimin e një faqeje interneti, për paketat e informacionit, për hartimin e një strategjie për marrëdhëniet me publikun të sporteleve të migracionit që janë pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe, për më tepër, për hartimin e një dokumenti politikash për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për politikbërjen për migracionin e punësimit të orientuar drejt zhvillimit.

Këto janë disa nga elementet konkrete që merr përsipër të zhvillojë ky projekt.

Për sa i përket çështjes së strategjisë për migracionin e rregullt, ajo ka mbaruar që në vitin 2015, se informacion nuk kemi në këtë moment, një strategji, një dokument politik, për sa i përket migracionit.

Sikurse ju e përmendët, bashkëpunimi me drejtoritë e policisë dhe pikat kufitare është shumë i rëndësishëm. Shërbimi Kombëtar i Punësimit ofron shërbime për ata të cilët vijnë te SHKP-ja dhe mund të themi që vetëm një fraksion i vogël i personave, të cilët mund të jenë migrantë të kthyer, paraqiten pranë zyrave të punës. Janë pikërisht këto materiale promovuese që synojnë që individët, të cilët kthehen në Shqipëri të marrin informacionin e duhur.

Aktualisht mund të them se migrantëve të kthyer pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit u shërbehet me një sërë programesh, një ndër to është programi i nxitjes së punësimit. Kuptohet që numri i përfituesve është relativisht i ulët, vetëm 5,8% e gjithë punëkërkuesve janë migrantë të kthyer, bëhet fjalë për 96 persona të kthyer në vitin 2017.

Gjithashtu, një numër i limituar kanë përfituar nga kurse profesionale afatshkurtra, 47 migrantë kanë përfituar nga kurse të formimit profesional. Në total pranë zyrave të punës gjatë vitit 2017 janë paraqitur 530 persona.

Këto të dhëna, natyrisht duhet të rakordohen me Ministrinë e Brendshme për të parë se si krahasohet ky numër me migrantët e kthyer në total. Jemi koshientë që bëhet fjalë për një numër relativisht të ulët të tyre.

Projekti në vetvete synon të targetojë dhe të adresojë nevojat për informacion të rreth 2000 personave në vit.

Mimi Kodheli – Zonja Sorensen, besoj se ky projektligj vjen në parlament për shkak të kostove financiare që lidhen me TVSH-në, apo jo? Në fakt, do të ishte mirë edhe në vazhdim të asaj që kolegu tha më parë, që për nivele kaq të ulëta shumë parash, të mos vihej në parlament. Të kishim një limit mbi të cilin të diskutojmë. Nuk flitet tani për 45 mijë euro TVSH në vit, ku përfitues mund të jenë me mijëra qytetarë, dhe të diskutohet e ridiskutohet në parlament. Kjo është një gjë, të cilën mund ta shikoni edhe ju vetë e ta sillni si propozim të ligjit mbi të cilin bazohet detyrimi juaj për ta paraqitur në parlament dhe për të diskutuar edhe për 45 mijë euro.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, pra, por mund të ketë një tavan të kësaj gjëje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E hedhim në votim projektligjin.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Neni 1.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

E hedhim në votim në tërësi.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Faleminderit, miratohet!

Faleminderit, zonja Sorensen!

Punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA